


AKT THEMELIMI

Ne Korce sot me 09.12.2005 themeluset e shoqerise : 1- DEFRIM DERVISHI ibiri I Hysenit me datelindje 18.11.1968 me adrese banimi Rr Viktor Eftimiu , Lgj 16 , Pallati 32\8 Korce , me numer pashaporte Z 0021571. 2- PRANVERA SHAHINASI ebija e Fazliut me datelindje 18.07.1964 me adrese banimi Rr Ismail Latifllari , banesa Nr 8 , Korce me numer leternjoftimi Ez 086209. 3- VALTER MYSLINJ I biri I Syrjait me datelindje 26.04.1959 me adrese Rr Rexhep Tela , Lgj 16 , Pallati 33 , Korce me numer pashaporte Z 0052791 . 4- MANOL BEQIRLLARI I biri I Refikut , Lindur me 12.04.1962 , banues Rr Rexhep Telaj , Lgj 16 , Pallati 33 , Korce , me numer pashaporte 1862824 vendosin dhe themelojne shoqeri anonime me emertimin KORCA – GAS shoqeri anonime tregtare dhe industriale sipas dispozitave te nenit 738 Dt 19.11.1992 “ Per shoqerite tregtare “ , ligjit 7512 Dt 10.08.1991 , Legjislacionit ne fuqi dhe sipas kushteve e marveshjeve te meposhtme .

NENI 1

- 1- Selia e shoqerise percaktohet ne qytetin e Korces Shqiperi me adrese Rr Korce – Morave – Drenove .
- 2- Shoqeria mund te hape filiale zyra dhe magazine edhe ne qytete , rethe te tjera , bernda dhe jashte shqiperise me vendim te keshillit mbikqyres te kesaj shoqerie , I cili do te percaktoje objektin dhe shtrirjen e ketyre punimeve si dhe fushen e juridiksionit dhe funksionimit ne pergjithesi .
- 3- Shoqerija mund te paditet dhe te padise ne seline e saj per cdo mos mareveshje ne lidhje me rastet ku per arsye tej juridiksioneve te vecante mund te padite jashte selise se saj , per vec rastit kur ligji percaketon ndryshe
- 4- Shoqerija ka mundesi me vendim te asamblese se pergjitheshme qe ndryshon kete nen te trasferoje seline e saj ne qytet ose reth tjeter te Shqiperise



NENI 2

Shoqëria është person juridik shqiptar dhe veprimtaria e saj përkohet nga Legjislacioni Shqiptar në lidhje me veprimet dhe aktet e saj tregtare doganore dhe tatimore si dhe nga dispozitat e të drejtës civile të Republikës Shqiptare.

NENI 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

- 1) Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i të gjitha llojeve të bombolabëve dhe bombolavëve të gazit.
- 2) Prodhimi, importimi, eksportimi dhe tregtimi i ngrohësve, i kaldajave, kaloriferive - fucive - bombolavëve - sistemeve të ngrohjes dhe të gatimit, si dhe sistemeve qendrore të pajisjeve për gazit natyror.
- 3) Studimi, ndërtimi dhe instalimi i sistemeve qendrore dhe të pajisjeve të gazit natyror në industri, në tregti, në shtet, në institucione dhe organizma dhe për përdorim shtëpiak, si dhe mbushja e bombolavëve me gaz dhe disponimi i tyre për çdo lloj përdorimi.
- 4) Puna kërkimore, krijimi, promovimi, administrimi dhe zbatimi i programeve biznesiale, tregtare dhe industriale për përdorimin e gazit, për shfrytëzimin e financimeve, subvencionimeve dhe kreditimeve të K.E. të Qeverisë Shqiptare, të brendshme dhe të jashtme dhe të qeverive të tjera dhe organizmat ndërkombetare për veprimtari biznesiale, tregtare, industriale dhe shtëpiake.
- 5) Importimi, eksportimi dhe tregtimi i gazit brenda dhe jashtë vendit



- 6.) Per arritjen e objektivave te mesiperme shoqeria do te ndertoje ose do te ose do te marre ne zoterim te saj me cdo lloj menyre nderdesat dhe paisjet e domosdoshme .
- 7) Perfaqesimi Brenda dhe jashte vendit , I shoqerive te huaja ose te vendit te ngjashme si dhe organizmave dhe ngarkimi I perfaqesimit te saj jashte shtetit.
- 8) Bashkepunimi me cfaredo lloj menyre , me persona fizike ose juridike vendas ose te huaj ne Shqiperi per arritjen e objektivave te ngjashme ose te peraferta me ato qe permendem me lart .

NENI 4

Kohezgjatja e shoqerise eshte e percaketuar dhe fillon nga dita e regjistrimit te saj ne regjistrin tregetar te te Gjykates se rethit Tirane . Mbas ketij regjistrimi shoqeria duhet te marre te gjitha lejet e domosdoshme per ushtrimin veprimtrise se sa tregetare profesionale dhe prodhuese .


Shoqerija mund te priset dhe perpara mbarimit te afatit qe percaktohet ne Statut me vendim te Asamblese se Pergjitheshme qe merret sipas dizpozitave te ketij statuti dje ligjit

NENI 5

Kapitali themeltar I shoqerise eshte me vlere 2 500 00 lek

1- DEERIM DERVISHI :625 000 lek , 2- PRANVERA SHAHINASI (625 000 Lek) , 3- VALTER MYSSLINJ 625 000 Lek , 4 - MANOL BEQIRLLARI :625 000 lek

Kapitali aksionar I shoqerise eshte 2 500 000 lek dhe ndahet ne 1000 aksione nominative me vlere nominale 2500 lek sejcila . Themelusit kane sejcili /250 aksione ose nga 25 % te kapitalit aksionar te shoqerise .





NENI 6

Aksioneret nuk kane pergjegjesi kundrejt personave te trete ose te shoqerise me shume se vlera nominale e aksioneve te tyre. Aksioneret jane pergjegjes ndaj shoqerise per detyra qe mund t'i shkaktojne ne veprimtarine e saj ekonomike dhe financiare, nese vepruan me qellim per shkaktimin e demit.

NENI 7

Te ardhurat qe realizohen nga veprimtaria e shoqerise mbas zbrithjes se cdo lloj detyrimi ndaj te treteve, shtetit dhe firmes, do te ndahen tek ortakët ne raport me aksionet qe zoterojne.

NENI 8

Ne detyrimet e themeluesve – aksionereve te shoqerise perfshihen dhe sa me poshte vijojne:

- a) Depozitimim e te gjithe dokumentave justifikuese ne autoritetet dhe organizmat kompetente per marrjen e lejeve te domosdoshme per fillimin e funksionimit te shoqerise
- b) Fillimin e veprimtarise tregatë, profesionale dhe prodhuese te shoqerise
- c) Sigurimin me cfaredo lloj menyre te pajisjeve mekanike, elektrike, te nderesave, si dhe lendeve te para dhe ndihmese dhe mallrave, si dhe te cdo lloj mjete tjeter te domosdoshem per funksionimin e shoqerise
- d) Sigurimin e personelit te domosdoshem (puneter, nepunes administrate) per funksionimin dhe administrimin e shoqerise

e) Derdhjen dhe mbulimin e kapitalit fillestar perkates nga secili prej tyre.

NENI 9

Organet Drejtuese te shoqerise jane:

- a) Asambleja e Aksionereve (e Zakonshme dhe e Jashtezakonshme)
- b) Keshilli Mbikqyres
- c) Drejtoria


Per kontrollin e ligjshmerise dhe administrimin financiar te veprimeve te shoqerise do te emerohet nga shoqeria nje Ekspert Kontabal i Autorizuar

NENI 10

Aksioneret, punonjesit e shoqerise, cdo anetar i Keshillit Mbikqyres dhe i Drejtorise jane te detyruar te ruajne ne menyre absolute sekretet e shoqerise qe ata njohin duke patur kete cilesi, si dhe te ruajne ose te mos bejne te njohur, me cfaredo menyre, tek cilido i trete, person fizik ose juriduk te dhena qe lidhen me veprimtarine ekonomike, profesionale, tregtare dhe prodhuese te shoqerise qe ata njohin me cfaredo lloj menyre. Ne rast se shkelet dispozita e mesiperme atehere kerkohen prej tyre pergjegjesi civile dhe penale dhe detyrohen te paguajne demshperblim per cdo dem real ose fitim te munguar qe u shkaktua ne shoqeri nga veprimet e tyre.

NENI 11

Menyra e organizimit, e administrimit te shoqerise dhe kontrolli i organeve te shoqerise dhe te veprimtarise se saj do te behet sipas Statutit te saj, dispozitave perkatese qe lidhet me shoqerite tregtare dhe Ligjin "Per perpunimin, transportimin dhe tregtine e naftes, gazit dhe nenprodukteve te tyre"



20

NENI 12

- Cdo mosmarveshje qe lind ndermjet aksionerve te shoqerise ose te shoqerise dhe te treteve do te zgjidhet ne ne baze te mirebesimit dhe parimet e shkembimit . Ne rast se nuk zgjidhen mosmarveshjet ne menyren mesiperme atehere do te zgjidhet nga Gjykata perkatese , ashtu sic percaktohet cdo here sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile .

Ky akt themelimi mbasi u lexua dhe u vertetua nga aksioneret themelues , ufirmos nga ata dhe u legalizua nga Noteri .

AKSIONERET THEMELUES

1- DEFRIM DERVISHI



2- PRANVERA SHAHINASI



3-MANOL BEQIRLLARI



4- VALTER MUSLLINJ

